

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIKIIN)

Përsosuria¹ / *el-Ihsaan* / الإِحْسَانُ

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Për sa i përket seksionit të Luginave, kjo ka dhjetë kaptina: Përsosuria, dija, urtësia, erudicioni, mprehtësia, admirimi, frymëzimi, prehja, rehatia, dhe aspirimi.

Allahu ﷻ tha:

"هَلْ جَزَاءُ الْإِحْسَانِ إِلَّا الْإِحْسَانُ"

"A të ketë shpërblim tjetër për të mirën (*ihsaan*) përveç të mirës." (e-Rahmaan, 60)

Përmendëm në fillim të librit se *ihsaan* është një shprehje pejgamberike, që përshin të gjitha format e së vërtetës. *Ihsaan* do të thotë ta adhurosh Allahun sikur ta shihje.² Kjo ka tri nivele:

Niveli i parë: Përsosuria në nijet:

¹ Përsosuri / mirësi / zbukurim. *Ihsaan* është një emër foljor që vjen nga "*husn*" (hijeshi). Kjo do të thotë të bësh gjëra me hijeshi ose të bësh gjëra të hijshme. Ai që bën një gjë të hijshme, është një *muhsin*. Përmirësimet estetike i shtohen një strukture vetëm pasi ajo të përfundojë. Prandaj, hijeshia është përsosuria fundore, që përfshin të gjitha format e përsosurisë, duke e treguar si të mirë bashkëveprimin e personit, meqë, ndërsa padrejtësia është e ndaluar dhe drejtësia është e kërkuar, mirësia është mënyra më e përsosur dhe më e inkurajuar me të cilën rob mund të sillet.

² Kjo është një pjesë e hadithit të gjatë të Xhibrilit ﷺ, ku ai pyet të Dërguarin e Allahut ﷻ rreth Islamit, imanit, dhe *ihsaanit*. *Ihsaan* në kontekstin e këtij hadithi është forma fundore e përsosurisë. Pavarësisht sa e përsosur është një vepër, motivi dhe qëllimi i saj është ajo që përcakton përfundimisht vlerën e saj të vërtetë. Kur qëllimi përfundimtar të jetë burimi i përjetshëm i tërë hijeshisë dhe i përsosurisë, *ihsaani* nuk do të jetë më për mburrje, për njohje, një anim nga një virtut i caktuar ose një aspirim për çfarëdo dëshire tjetër veç kënaqësisë hyjnore, duke qenë kështu një *ihsaan* i qëndrueshëm, i vendosur dhe i balancuar.

- Duke e përpunuar me dije³
- Duke e përforcuar me vendosmëri⁴
- Duke dëlir gjendjet⁵ (shoqëruese) të tij

Niveli i dytë: Përsosuria në gjendjet (shpirtërore), që nënkupton:

- Të kujdesesh për to duke i mbrojtur⁶
- T'i fshehësh me merak⁷
- T'i ndreqësh për një realizim të plotë⁸

Niveli i tretë: Përsosuria në menaxhimin e kohës, dhe kjo bëhet:

- Duke mos pushuar së pari (hyjnoren)
- Duke mos lënë që dikush a diçka tjetër të jetë objekt i aspirimit tënd
- Duke migruar tek i Vërteti i përhershëm

³ Të bësh atë që duhet në kohën e duhur, në vendin e duhur, në rrethanat e duhura, dhe për shkakun e duhur, në përputhje me instruksionet hyjnore, të përcjella nga i Dërguari ﷺ në Kuran dhe në Sunet.

⁴ Vendos të veprosht me nijet të mirë dhe ta përfundosh atë që e fillon në mënyrën më të mirë të mundshme.

⁵ Të sigurohesh që gjendjeve të zemrës - dashuria, frika, shpresa, shqetësimi, dhe intimitetit nëpër të cilën ti kalon gjatë shërbimit - t'u hiqet çfarëdo papastërtie.

⁶ Sepse ato mund të jenë kalimtare dhe mund të humbin, nëse ti nuk i ruan.

⁷ Më shumë fsheh gjendjet e tija një njohës i njëmendtë i Allahut ﷻ sesa një person i pasur paratë e tija. Ai i lë ato të shihen vetëm në rast domosdoshmërie.

⁸ Personi gjithmonë duhet ta kërkojë përsosjen e mëtejme dhe pastrimin e gjendjeve të tija (shpirtërore).